



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: “NDREGJONI” sh.p.k. me NUIS: K31329048I

Adresa: Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8, Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “*Procedurë e hapur e thjeshtuar, shërbime*”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-75601-07-20-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “*Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore – Lyerje ndërtesash*”, me fond limit 9,206,264 (nëntë milion e dyqind e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, i ndarë si më poshtë:

Për Fakultetin e Mjekësisë: 7,083,100 (shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike: 2,123,164 (dy milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike –Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k. me NUIS: L31615017L

Vlera e ofertës pa tvsh = 6,000,000 (gjashtë milion) lekë.

2. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k. me NUIS: J61814009W

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,960,660 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” sh.p.k. me NUIS: J96409033R

Vlera e ofertës pa tvsh = 6,191,390 (gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.

4. Operatori ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k. me NUIS: K31329048I

Vlera e ofertës pa tvsh = 8,675,400 (tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë.

5. BOE “TEA-D” sh.p.k. me NUIS: K32522629L dhe “COGREN” sh.p.k. me NUIS: J74818825K

Vlera e ofertës pa tvsh = 6,448,400 (gjashtë milion e katërqind e dyzetë e tetë mijë e katërqind) lekë.

6. Operatori ekonomik “UDHA” sh.p.k. me NUIS: K77524909Q

Vlera e ofertës pa tvsh = 6,712,100 (gjashtë milion e shatëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind) lekë.

7. Operatori ekonomik “VALONA KONTRUKSION” sh.p.k. me NUIS: K26330202E

Vlera e ofertës pa tvsh = 9,000,430 (nëntë milion e katërqind e tridhjetë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k. me NUIS: L31615017L

Për arsyet e mëposhtme:

Operatorit ekonomik “2 N” sh.p.k. me NUIS: L31615017L, dorëzoi dokumentacionin me shkresën nr. 96 prot., datë 17.08.2023 me lëndë: “*Dorëzim dokumentacioni*”, protokolluar pranë UMT-së me nr. 2297/24 prot., datë 17.08.2023.

Nga kontrolli i dokumentacionit të dorëzuar, u konstatua se:

1. Nuk është dorëzuar dokumenti për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, në kundërshtim pikën 6, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, ku citohet se: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”. Bazuar në gjermën e), pika 2 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike.
2. Nuk përmbush kriterin 2.3.5. të kapacitetit teknik për disponimin e punonjësve të specializuar / të kualifikuar, pasi:

- Për punonjësën E.H. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/12 prot., datë 18.05.2023, me detyrën bojaxhi. Ky punonjës është deklaruar bojaxhi dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në listëpagesat e dorëzuara për periudhën prill-qershor ky punonjës është i deklaruar me kodin 2611.03 që i përket profesionit jurist. Për punonjësit bojaxhi është kërkuar dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diploma. Operatori ekonomik ka deklaruar në listën e punonjësve, që institucioni që ka lëshuar certifikatën / diplomën është Qendra e Trajnimeve të Avancuara, QTA. Nuk është paraqitur dokumenti i deklaruar.
 - Për punonjësën F.Q. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/13 prot., datë 18.05.2023, me detyrën punëtor i thjeshtë. Ky punonjës është deklaruar punëtor i thjeshtë dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në listëpagesat e dorëzuara për periudhën prill-qershor ky punonjës është i deklaruar me kodin 2631.13 që i përket profesionit ekonomist.
 - Për punonjësën E.D. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/10 prot., datë 18.05.2023, me detyrën bojaxhi. Ky punonjës është deklaruar bojaxhi dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në listëpagesat e dorëzuara për periudhën prill-qershor ky punonjës është i deklaruar me kodin 8332.11 që i përket profesionit drejtues i makinave të rënda. Për punonjësit bojaxhi është kërkuar dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diploma. Operatori ekonomik ka deklaruar në listën e punonjësve, që institucioni që ka lëshuar certifikatën / diplomën është Qendra e Trajnimeve të Avancuara, QTA. Nuk është paraqitur dokumenti i deklaruar.
 - Për punonjësën P.H. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/32 prot., datë 18.05.2023, me detyrën bojaxhi. Ky punonjës është deklaruar bojaxhi dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në listëpagesat e dorëzuara për periudhën prill-qershor ky punonjës është i deklaruar me kodin 2133.13 që i përket profesionit inxhinier pyjesh. Për punonjësit bojaxhi është kërkuar dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diploma. Operatori ekonomik ka deklaruar në listën e punonjësve, që institucioni që ka lëshuar certifikatën / diplomën është Qendra e Trajnimeve të Avancuara, QTA, ndërkohë që ka certifikatë trajnimi nga AQSCERT.
 - Për punonjësën A.T. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/22 prot., datë 18.05.2023, me detyrën bojaxhi. Për punonjësit bojaxhi është kërkuar dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diploma. Operatori ekonomik ka deklaruar në listën e punonjësve, që institucioni që ka lëshuar certifikatën / diplomën është Qendra e Trajnimeve të Avancuara, QTA, ndërkohë që ka certifikatë trajnimi nga AQSCERT.
 - Për punonjësën N.B. është paraqitur kontrata e punës nr. 51/31 prot., datë 18.05.2023, me detyrën bojaxhi. Ky punonjës është deklaruar bojaxhi dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për punonjësit bojaxhi është kërkuar dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diploma. Operatori ekonomik ka deklaruar në listën e punonjësve, që institucioni që ka lëshuar certifikatën / diplomën është Qendra e Trajnimeve të Avancuara, QTA. Nuk është paraqitur dokumenti i deklaruar.
3. Dokumentacioni është paraqitur kopje, në kundërshtim me pikës 5 të nenit 82 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të cilin citohet se: *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna”* si dhe shtojcën 8 të Dokumentave Standarde të Tenderit, ku nga APP që i ka hartuar këto dokumenta është shënuar **“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara”**.

Operatori ekonomik “INA” sh.p.k. me NUIS: J61814009W

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e operatorit ekonomik “INA” sh.p.k. u vlerësua anomalisht e ulët, në përputhje me nenin 93, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Autoriteti Kontraktor i kërkoi operatorit sqarime lidhur me përllogaritjen e ofertës. Pas kërkesës për sqarime nga Autoriteti Kontraktor, operatori ekonomik “INA” sh.p.k. nuk paraqiti me shkrim shpjegime në lidhje me çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

Operatori ekonomik “NDERTUESI 2000” sh.p.k. me NUIS: J96409033R

Për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik nuk kualifikohet sepse nuk ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Dokumentave Standarde të Tenderit, konkretisht shkronja I te pika 2.3.5 te kriteret e veçanta të kualifikimit:

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar se punonjësit Z.L.GJ, Z.B.L, Z.SH.P, Z.M.G, Z.GJ.F, Z.L.P, Z.I.K, Z.LL.B, Z.L.K, Z.M.C, Z.A.K, Z.B.M janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti “Re/Born”, me NUIS L71309019P. Lidhur me këto certifikata, pas verifikimeve në QKB rezulton se kjo shoqëri nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për BOJAXHI, SUVATUES dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

2. Referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) nuk është plotësuar sipas formatit, nuk vërteton se plotëson kërkesën e pikës 2.3.4. duke mos deklaruar që disponon 1 (një) Inxhinier Ndërtimi si dhe nuk vërteton se plotëson kërkesën e pikës 2.3.6 pasi nuk ka deklaruar që disponon 1 (një) punonjës të kualifikuar/certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

BOE “TEA-D” sh.p.k. me NUIS: K32522629L dhe “COGREN” sh.p.k. me NUIS: J74818825K

Për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomik “TEA-D” sh.p.k. dhe “COGREN” sh.p.k. nuk kualifikohet sepse nuk ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Dokumentave Standarde të Tenderit, konkretisht si më poshtë vijon:

1. Në preventivin e punimeve nuk kanë përcaktuar pjesën e punëve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, referuar përqindjeve të përcaktuara në kontratë ndërmjet palëve. Gjithashtu kjo përqindje nuk është përcaktuar as në sigurimin e ofertës. E cila është në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 88, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së,

ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë”.

2. BOE nuk përmbush pikën 2.3.5 të kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar punonjësit e kërkuar.
3. BOE nuk përmbush pikën 2.3.9 pasi nuk kanë paraqitur katalog/broshurë të bojërave hidroplastike për të verifikuar përputhshmërinë me specifikimet teknike.

Operatori ekonomik “UDHA” sh.p.k. me NUIS: K77524909Q

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “UDHA” sh.p.k. nuk kualifikohet sepse nuk ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Dokumentave Standarde të Tenderit, konkretisht të kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

1. Pika 2.3.2. lidhur me licencën profesionale të shoqërisë. Licenca e dorëzuar ka patur afat vlefshmërie deri më datë 16.02.2022.
2. Referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST dhe deklaratës për stafin), nuk vërteton se plotëson kërkesën e pikës 2.3.5 të lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar bojaxhi. Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit G.M dhe P.L., të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket kësaj shoqërie (ASHP), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Bojaxhi” dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Operatori ekonomik “VALONA KONTRUKSION” sh.p.k. me NUIS: K26330202E

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “VALONA KONTRUKSION” sh.p.k. nuk ka dorëzuar sigurimin e ofertës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k. me NUIS: K31329048I me adresë Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8, Njësia Bashkiake Nr. 8,

Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8,675,400 (tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, me adresë: Rruga e “Dibrës”, Nr. 371 – Tiranë, dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, me adresë: Rruga “Dibrës”, Nr. 371 – Tiranë, sigurimin e kontratës (sipas vlerave të shërbimeve që do të realizohen në secilin Fakultet), siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe procedura do të anulohet për arsye se nuk ka Operator Ekonomik tjetër të kualifikuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR